



**UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I EKONOMISË**



Miratohet

**DEKANI**

**Prof. Dr. Sulo HADËRI**

**UDHËZUES**

**MBI**

**PRAKTIKËN MËSIMORE**

**PËR STUDENTËT E MASTER-it PROFESIONAL**

**(me kohë të plotë)**

*Tiranë, Korrik 2012*

## 1. Aspekte të përgjithshme mbi Praktikat

Praktika mësimore përbën një element të rëndësishëm në kurrikulat e Masterit Profesional me kohë të plotë. Praktika parashikon të mundësojë përdorimin e njohurive të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik dhe profesional. Për të plotësuar kërkesat e parashikuara, studentët duhet të zhvillojnë praktikë në një ose disa institucione/organizata/kompani.

Përgjatë periudhës së realizimit të praktikës studenti duhet të përdorë dhe përfshijë njohuritë teorike të përfituara me njohuritë praktike për të synuar në këtë mënyrë drejt rrugëve të ardhshme të karrierës.

Studenti që nuk realizon programin e praktikës mësimore i nënshtrohet rregullave të vendosura si për të gjithë detyrimet e tjera. Studenti nuk mund të mbrojë mikrotezën pa kryer detyrimin e praktikës dhe pa u vlerësuar për të.

Si pjesë e programit të studimit është disiplinë e tipit E, e detyrueshme, zhvillohet në semestrin e 3 me një kohëzgjatje 3 mujore. Në kurrikulat e Masterit Profesional me kohë të plotë për praktikën mësimore parashikohen 15 kredite/300 orë (punë individuale, në kompani dhe takime me mbikqyrësin) me kohëzgjatje 12 javë mësimore.

Strukturat përgjegjëse për organizimin, ndjekjen dhe zhvillimin e praktikës mësimore janë:

- **Zv.Dekani** përgjegjës për ciklin e dytë të studimeve i cili koordinon dhe monitoron zhvillimin e praktikave mësimore për studentët e të gjitha Master-ave Profesionale (me kohë të plotë) në FE, UT;
- **Përgjegjësi i Departamentit** i cili organizon procesin e caktimit të pedagogëve përgjegjës për zhvillimin e seancave në auditor dhe për mbikëqyrjen e studentëve gjatë praktikës, si dhe drejton dhe monitoron procesin që nga momenti i caktimit të studentëve në institucione/organizata/ kompani e deri në momentin e vlerësimit të kësaj discipline me notë;
- **Zyra e Karrierës dhe e Praktikave** e cila kujdeset për parapërgatitjen e studentëve për procesin e praktikave mësimore dhe për orientimin e tyre në institucione/organizata/kompani.

## 2. Qëllimi i praktikës mësimore

Komponenti i praktikës mësimore synon t'i pajisë studentët me njohuri praktike si dhe t'u krijojë mundësi për punësim të mëtejshëm, sikurse edhe mundësi për:

- të zgjeruar dhe thelluar njohuritë teorike të përfituara gjatë procesit mësimor dhe krijuar aftësi profesionale praktike të rëndësishme për kërkime të mëtejshme post-master;
- t'u përballur dhe ekspozuar me kompani, organizata, institucione;
- të ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme dhe për të startuar krijimin e një rrjeti për pozicione të mëtejshme me kohë të plotë;
- të krijuar një ndikim pozitiv mbi kompaninë/organizatën/institucionin ku kryhet praktika.

Fakulteti i Ekonomisë shërben si një qendër inovative dhe sipërmarrëse e cila monitoron "sinjalet e tregut" për të ndërtuar dhe zhvilluar më tej programe dhe kurrikula të reja të përditësuara. Mbi këtë bazë praktika mësimore duhet të konsiderohet si një periudhë ku studenti koordinon në mënyrë aktive praktikën në kompaninë/organizatën/institucionin e përzgjedhur prej tij me fillimin e karrierës së tij apo projekte të tjera ku mund të përfshihet qoftë edhe në mënyrë vullnetare.

## 3. Proçesi i zhvillimit të praktikës mësimore

Për gjetjen e institucionit/organizatës/kompanisë ku do të zhvillojë praktikën studentit shfrytëzon database e FE, UT apo rrjetet individuale. Në fund të semestrit të dytë të procesit mësimor, studentit duhet të plotësojë një formular aplikimi (të cilin e shkarkon nga Faqja e Fakultetit [www.fakultetiekonomise.edu.al](http://www.fakultetiekonomise.edu.al)).

Shpërndarja e studentëve në kompani/institucione/organizata duhet të kryhet në bazë të shkallës së përputhshmërisë së preferencës së studentit me programin e studimit dhe cilësinë e CV-së së tij. Kjo shpërndarje miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit i cili vendos edhe pedagogun që do të udhëheqë përgjatë praktikës studentin i cili mund të jetë ose jo udhëheqës i mikrotezës së tij. Lista përfundimtare e shpërndarjes së studentëve sipas kompanive/institucioneve/organizatave së bashku me pedagogët mbikëqyrës afishohet pranë departamenteve përkatëse.

Në fund të praktikës dhe përpara mbrojtjes së raportit të saj përfundimtar, studentit praktikant ka për detyrë të dorëzojë pranë departamentit:

- a. formularin e vlerësimit të studentit nga pedagogu mbikëqyrës;
- b. formularin e vlerësimit të studentit nga mbikëqyrësi në kompani/institucion/organizatë;
- c. raportin përfundimtar të praktikës të përgatitur nga studentit sipas formatit përkatës.

I gjithë dokumentacioni i sipërpërmendur mund të shkarkohet nga Faqja e Fakultetit [www.fakultetiekonomise.edu.al](http://www.fakultetiekonomise.edu.al).

#### **4. Detyrimet e studentit gjatë praktikës mësimore**

Studenti i Masterit Profesional duhet të konsiderojë praktikën si një proces të pashkëputur nga procesi i kërkimit në funksion të realizimit të Mikrotezës. Në kompaninë e përzgjedhur studentit përgjatë periudhës së praktikës mësimore synon të krijojë kontakte dhe rrjete komunikimi me përfaqësues të niveleve të ndryshme manaxheriale, të burimeve njerëzore, etj, të marrë pjesë aktive në funksione të ndryshme brenda kompanisë të përcaktuara edhe nga Mbikëqyrësi si dhe të ofrojë mbështetjen dhe rolin e tij modest.

Praktika mësimore duhet të konsiderohet si një program vullnetar ku studentit duhet të hartojë një raport, raport i praktikës mësimore, nga i cili mund të përfitojë *studenti, kompania dhe Fakulteti i Ekonomisë*.

Detyrimet e studentit përgjatë periudhës së praktikës janë:

- të ndjekë praktikën profesionale sipas parashikimit në planin mësimor;
- të respektojë rregulloren dhe kushtet e punës të kompanisë/organizatës/institucionit përkatës;
- të jetë i gatshëm të kryejë detyrat e ngarkuara;
- të plotësojë dhe të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e praktikës sipas parashikimeve të këtij udhëzimi;
- të hartojë raportin përfundimtar të praktikës mësimore të cilin do ta referojë dhe do të vlerësohet përpara Komisionit të Vlerësimit.



## 5. Vlerësimi i Praktikës

Përgjatë gjithë kohës së kryerjes së praktikës studenti është nën udhëheqjen dhe mbikqyrjen e një pedagogu të fushës së tij (i cili është anëtar i Departamentit përkatës), i cili në përfundim të afatit 3 mujor të praktikës dhe përpara procesit të mbrojtjes para Komisionit të Vlerësimit, jep aprovimin dhe vlerësimin e tij nëpërmjet plotësimit të një formulari. Në këtë formular jepet një vlerësim i përgjithshëm i ecursionit të praktikës mësimore.

Me propozim të Përgjegjësit të Departamentit dhe me miratim të zv.dekanit përgjegjës për ciklin e dytë të studimeve njoftohet kalendari i provimit të praktikave mësimore dhe përbërja e komisioneve vlerësuese. Komisioni i Vlerësimit përbëhet minimalisht nga dy pedagogë të departamentit përkatës dhe nga mbikëqyrësi i studentit në kompani (nëse ky i fundit dëshiron).

Praktika mësimore vlerësohet me notë ashtu sikurse të gjitha disiplinat e tjera të ciklit të dytë të studimeve.

## 6. Përjashtime nga rregulli

- *Mbrojtja e praktikës mësimore jashtë afatit të përcaktuar*

Studenti që nuk realizon procesin e mbrojtjes së praktikës mësimore brenda afatit normal të përcaktuar, i krijohet mundësia ta kryejë atë në një periudhë tjetër të përcaktuar nga Dekani.

- *Praktika mësimore për studentët në marrëdhënie pune*

Nëse një student punon me kohë të plotë ose të pjesshme gjatë periudhës që ka detyrim të kryejë praktikën mësimore, atij mund t'i konsiderohet kjo punë si plotësim i detyrimit për praktikë nëse plotësohen të treja kushtet e mëposhtme:

- a. puna që ai/ajo kryen është në të njëjtën fushë me programin e studimit;
- b. studenti sjell një vërtetim nga punëdhënësi i cili pohon se studenti punon në këtë institucion/ organizatë/kompani, shoqëruar edhe me një përshkrim të punës që kryen,
- c. studenti paraqet një kërkesë pranë Përgjegjësit të Departamentit për njohje të punës së kryer si praktikë mësimore.

- *Praktika mësimore e zhvilluar jashtë afateve të përcaktuara*

Nëse studenti ka punuar gjatë 12 muajve të fundit, por jo gjatë periudhës në të cilën ka detyrim të kryejë praktikën (pra semestri i III), ai mund të paraqesë një kërkesë pranë Përgjegjësit të Departamentit, ku të kërkojë që kjo eksperiencë punësimi t'i konsiderohet si praktikë mësimore. Kërkesa mund të pranohet nëse verifikohen të dy kushtet e mëposhtme:

- a. puna që ai/ajo ka kryer është në të njëjtën fushë me programin e studimit;
- b. studenti sjell një vërtetim nga punëdhënësi i cili pohon se studenti ka punuar në institucion/ organizatë/kompani, shoqëruar edhe me një përshkrim të punës që ka kryer.

Nëse kërkesa pranohet (në të dy rastet e mësipërme) Përgjegjësi i Departamentit ngarkon një pedagog për të verifikuar punën e kryer nga studenti në institucionin/organizatën/kompaninë përkatëse. Në përfundim të verifikimit pedagogu paraqet një raport me shkrim sipas formatit përkatës të përshkruar më sipër dhe e dorëzon për vlerësim përfundimtar sipas të gjitha procedurave të përcaktuara.